

Nehemiah Gateway Albania

Qëllimi	Nehemiah Gateway Albania është një organizatë humanitare, e cila ka 25 vjet që vepron në Shqipëri. Synimi: Të sjellë një ndryshim pozitiv dhe të qëndrueshëm në gjendjen e njerëzve në nevojë dhe të përmirësojë kushtet e tyre të jetesës. Fokusi që ajo ka, është "Ndihmë për vetëzhvillim" për të siguruar dinjitetin dhe pavarësinë e tyre.	
Fillimi	Shqipëri 1991 – Arnold Geiger shkon si një nga ndihmësit e parë në një vend dikur të izoluar. Ai vendos të shpërngulet përgjithmonë me familjen e tij në Shqipëri. Bazuar në besimin e krishterë dhe mirënjohës për situatën e tyre, familja Geiger dëshiron të ndihmojë njerëzit në Shqipëri. Së bashku me vullnetarë të tjerë dhe donatorë themeluan Fondacionin Nehemia në Shqipëri, fondacion i cili u shndërrua në një organizatë humanitare me shumë projekte ndër vite.	
Historia	1991	Shqipëria hap dyert - transporti i ndihmave të para
	1992-1996	Projekte të ndryshme ndihmuese dhe projekte ndërtimi
	1997	Trazirat kombëtare në Shqipëri
	1998	Rindërtimi i projekteve të ndihmës dhe krijimi i Shkollës NEHEMIA
	1999	Kriza e refugjatëve në Kosovë – me furnizimin e 3000 personave nga Kosova
	2002	Hedhja e themeleve të kampusit në Buçimas me projektet shkollore dhe sociale
	2008	Hapja e Shkollës së Lartë "Nehemiah Gateway"
	2011	20 vjetori i Nehemiah Gateway
	2012	Dorëzimi i Nehemiah Gateway Albania një drejtuesi shqiptar
Qendra aktivitetesh	Gjirokastrë, Pogradec, Buçimas (Zyrat qendrore)	

Bashkëpunëtorë

Në Fondacionin Nehemiah Gateway Albania punojnë

- 97 bashkëpunëtorë shqiptarë
- 10 studentë me programin Work and Study
- 5 bashkëpunëtorë vullnetarë
- 2 vende pune për persona me nevojë të veçanta
- Kostot për personelin në vit shkojnë në 607.307 Euro
- Sigurimet shoqërore arrijnë vlerën prej 86,690 Eurosh në vit

Drejtimi strategjik

Katër shtyllat kryesore të punës në secilën Qendër Lokale janë: ndihma sociale dhe mjekësore, arsimi, fuqizimi i projekteve Project Empowerment dhe implementimi i vlerave themelore.

Kampusi në Buçimas

Sipërfaqja: 11.500 m²

8 ndërtesa: 6 prej tyre me energji efikase

Koncepti i energjisë:

- Termoizolim (6 ndërtesa)
- Sistem termik me panele diellore me ngrohje me temperaturë të ulët (5 ndërtesa)
- Pompë për ngrohje

Sistemi në raste emergjente:

- Gjeneratorë për raste emergjente
- Sistem fotovoltai
- Sistem alarmi

Planet e zhvillimit

Nehemiah Gateway Albania është forcuar si një qendër për arsimim dhe Multiplikationszentrum. Ajo po kalon në fazën e ardhshme të zhvillimit.

Shërben si model "praktika më e mirë" për qendrat e tjera lokale në vende të ndryshme në mbarë botën, ku janë edhe projektet e Nehemiah Gateway, të cilat aplikojnë programe zhvillimi dhe metoda të provuara më parë.

Në Shqipëri, liderat dhe drejtuesit shkollohen dhe promovohen nëpërmjet Studimeve Duale, të cilat kanë në fokus përgjegjësinë individuale dhe kompetencat.

Grupet e synuara janë gjithnjë e më shumë njerëz në nevojë dhe ata me sfida të veçanta sociale.

Nehemiah Gateway Albania – Projekte

Një vend strehimi - Shkolla Amaro Tan dhe projekte

Amaro Tan do të thotë “vendi ynë” në gjuhën e romëve. Ky vend është një projekt i financuar me një shkollë në Pogradec, Shqipëri për 140 fëmijë nga familje të varfra dhe rome. Programi Amaro Tan i është përshtatur plotësisht nevojave të fëmijëve. Krahas mësimit nga kopshti deri në klasën e 9-të zhvillohen kurse të ndryshme praktike dhe muzike. Kujdesi social, psikologjik dhe mjekësor, mensa e shkollës çdo ditë, kampet verore dhe mbështetja materiale për familjet, jo vetëm i mbron fëmijët nga rreziku i jetës në rrugë, trafikimi dhe martesë e detyruar, por edhe u jep atyre shanse të mira për të ardhmen, deri edhe në ofrimin e mundësisë për ndjekjen e studimeve në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway.

Ndryshim i qëndrueshëm përmes arsimimit – Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway

Në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway përgatiten liderë të ardhshëm nga e gjithë bota për një karrierë të suksesshme. Nëpërmjet iniciativave të tyre, shumë studentë duan të krijojnë ndryshime pozitive apo të kujdesen për profesionalizmin dhe rritjen e organizatave humanitare në vendet e tyre. Për këtë ata marrin këshillim dhe përkrahje të shumëllojshme nga Nehemiah Gateway në kuadër të Project Empowerment. Diplomat e të dyja programeve, B.A. në ‘Ekonomi dhe Biznes’ si edhe M.Sc. në ‘Leadership dhe Vlerësim Arsimit’ janë të njohura në Gjermani, SHBA dhe së shpejti edhe në Shqipëri.

Në shtëpi me më të varfrit e të varfërve - shërbime në shtëpi në Shqipëri

Në Shqipëri, shumë njerëz të moshuar apo persona me nevoja të veçanta kanë nevojë për ndihmë. Në vizitat e shërbimeve në shtëpi Nehemiah Gateway kujdeset për secilin prej tyre me ushqim dhe veshmbathje, punët e shtëpisë, procedura të ndryshme në administratën publike, trajtime mjekësore, fizioterapi, e shumë të tjera. Gjurmët e punonjësve të Nehemiah Gateway i gjen deri në fshatrat më të thella malore, ku nevoja është edhe më e madhe.

Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway – një strukturë arsimore dhe kërkimore e Nehemiah Gateway Group në Shqipëri

SHIFRA DHE FAKTE

- Qëllimi:** Qëllimi i Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway është të arsimojë të rinj të talentuar. Kështu krijohet një gjeneratë e re me drejtues, të cilët bëhen themelue të saj ose punojnë për kompanitë, OJQ-të ose për administratën publike. Studentët gjithashtu kanë mundësinë për të qenë aktivë në organizatat partnere apo motra të Nehemiah Gateway Group.
- Fillimi:** Shkolla e Lartë mori në vitin 2008 licencën nga qeveria shqiptare. Studentët e parë filluan studimet e tyre në janar të vitit 2010.
Shkolla e Lartë ka dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë.
- Programe studimi:** Aktualisht ka dy programe studimi: Bachelor në 'Ekonomi dhe Biznes's' (pesë kurse studimi, një total prej 24 të diplomuarish dhe 41 studentë) dhe Master i Shkencor në „Leadership and Vlerësim Arsimor“ (dy kurse studimi, një total prej 16 të diplomuarish dhe 11 studentë). Një kurs i ri studimi për B.A. pritet në janar 2017 dhe për M.Sc. fillon në tetor 2016. Shkalla e punësimit e të diplomuarve tanë është 82.5%, ndërsa 12.5% prej tyre kërkojnë të vazhdojnë studime të mëtejshme dhe 5% të tjerët për arsye familjare nuk janë duke punuar.
- Bashkëpunëtorët:** Grupi i studentëve në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway është ndërkombëtar. Ata vijnë nga Shqipëria, Gjermania, Greqia, nga disa vende afrikane si Uganda, Sudani i Jugut dhe Tanzania, si dhe nga Amerika Latine respektivisht nga Meksika. Më shumë se 70 përqind e stafit akademik vijnë nga vendet e Evropës Perëndimore si Gjermania, Zvicra, Britania e Madhe dhe SHBA. Në këtë mënyrë, pedagogët e huaj sjellin gjetjet e fundit në hulumtim dhe mësimdhënie, të cilat nëpërmjet punonjësve vendas implementohen më pas në kontekstin shqiptar.
- Akreditimi:** Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway është e vetmja Shkollë e Lartë në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor që ka përfunduar me sukses akreditimin në SHBA. Të dyja programet e studimit janë të akredituara në Gjermani. Programi Bachelor është i akredituar edhe në Shqipëri, ndërsa programi Master është ende në proces akreditimi në Shqipëri.
- Fokusi:** Fokusi është përqëndruar në integrimin e teorisë dhe praktikës, veçanërisht në studimet duale. Në këtë mënyrë studentët ndihmohen për të gjetur punë dhe të rriten më tej profesionalisht. Praktika e studentëve mundësohet nga firmat partnere të organizatës që ndodhen në Shqipëri, Gjermani, Zvicër, Ugandë, Tanzani dhe Meksikë.
- Planet e zhvillimit:** Shkolla e Lartë duhet të shërbejë gjithashtu edhe si një qendër trajnimi. Në të ardhme, nëpërmjet praktikave, të interesuarit mund të kualifikohen ose të përgatiten si pjesë e një trajnimi ose arsimimi të mëtejshëm. Shkolla ka gjithashtu për qëllim formimin e drejtuesve të ardhshëm me metoda moderne të të mësuarit interaktiv. Kjo është bërë përmes përdorimit të Laboratorit të Studimit nga partnerët ndërkombëtarë dhe është shoqëruar nga një grup i vogël kërkimor.

Studentë të Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway



Eduart Gjona
23, Shqipëri, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

„Ne kemi profesorë nga e gjithë Evropa, SHBA madje edhe nga India. Kështu që unë, që në fillim në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway, njoha të menduarit dhe të punuarit ndërkombëtar. Unë mendoj se kjo është shumë e rëndësishme, pasi pjesa më e madhe e kompanive kanë aktivitet ndërkombëtar ditët e sotme. Gjatë studimeve të mia unë kam pasur kontakt dhe kam njohur njerëz nga kultura të ndryshme dhe me ide të ndryshme. Ata më japin përvoja, të cilat do t'i merrja më me vështirësi më vonë, kur të filloj punë.



Haleluya Johanes Kasimbazi
23, Tanzania, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Arsyeja pse më pëlqen Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway është sistemi dual i studimit. Këtu unë mund të grumbulloj përvoja të shumta që do të jenë një ndihmë e madhe për mua në të ardhmen në profesion. Ky është një ndryshim themelor nga universiteti im në Afrikë. Akreditimi FIBAA (agjencia evropiane, me orientim ndërkombëtar për sigurimin e cilësisë së institucioneve) e Shkollës së Lartë më jep sigurinë se do të përgatitem në mënyrën më të mirë të mundshme për karrierën time në të ardhmen. Unë i vlerësoj shumë profesorët dhe pedagogët tanë kompetentë.



Enxhi Bajraktari
21, Shqipëri, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Ka shumë arsye pse unë kam zgjedhur Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway dhe jo një universitet tjetër në Shqipëri. Këtu kam mundësi që çdo gjë të cilën e kam mësuar në mësim ta provoj në praktikë. Përveç kësaj, mësimi zhvillohet në gjuhën angleze, kështu që unë mund ta praktikoj dhe ta përmirësoj anglishten. Shkolla e Lartë është e akredituar ndërkombëtarisht. Kështu që unë mund të vazhdoj studimet për programin Master jashtë

Shqipërisë.



Markus Drotleff
28, Gjermani, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Për mua personalisht, e veçanta e Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway është kombinimi i teorisë dhe praktikës. Kjo do të më ndihmojë në rrugën time për të ecur përpara. Veçanërisht interesante është për mua, krijimi i kontakteve me kompanitë dhe bizneset, njohja me njerëz kompetentë dhe të suksesshëm profesionalisht si dhe marrja e sugjerimeve prej tyre. Qëllimi im është të hap një biznes në vendin tim për të mbështetur sidomos të rinjtë për të jetuar një jetë kuptimplotë.



Herolinda Shkullaku M.A.

Drejtoresh Ekzekutive – Nehemiah Gateway Albania

Herolinda Shkullaku, lindur më 1976 në Pogradec, Shqipëri, është pjesë e Nehemiah Gateway Albania që kur ka qenë fare e re. Ajo ka kryer studimet për gjuhë të huaj në Universitetin e Tiranës dhe që prej vitit 2002 ka pasur pozicione të ndryshme ekzekutive drejtimi te Nehemia në Shqipëri. Në vitin 2013, ajo mori përsipër drejtimin e Nehemiah Gateway Albania me mbi njëqind punonjës dhe me projekte ndihmuese të shumëllojshme. Në të njëjtën kohë ajo përfundoi studimet e saj të dyta në programin Bachelor për 'Biznes dhe Ekonomi' në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway. Herolinda Shkullaku është e martuar dhe ka një djalë.



Arnold Geiger

Partner dhe Drejtor Menaxhues i Nehemiah Gateway gGmbH

I diplomuar për të punuar në Administratë Publike (FH) ka qenë punonjës për nëntë vjet në funksione të ndryshme në Policinë Federale të Gjermanisë. Pas transporteve humanitare dhe veprimtarive në shumë vende, duke përfshirë Eritrean, Malavinë, Etiopinë, Rusinë, Rumaninë, Turqinë, Iranin dhe Sudanin, në vitin 1991, pas hapjes së kufijve vendosi të shkonte me familjen e tij në Pogradec, Shqipëri. Që prej këtij viti ai drejton atje ndihmë për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshme. Për angazhimin e tij të madh ai mori Urdhërin e Meritës në vitin 2008. Arnold Geiger ka pesë fëmijë me gruan e tij Esther.

Nehemiah Gateway – Shifra dhe Fakte

Nehemiah Gateway gGmbH është një organizatë ndërkombëtare humanitare me aktivitete në Evropën Juglindore, Afrikë dhe Amerikën Latine.

Orientimi kryesor i Nehemiah Gateway është të ndihmojë dhe fuqizojë njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme të formojnë dhe përcaktojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi. Bazohet në katër shtylla kryesore: Ndihma sociale dhe mjekësore, Edukimi, Fuqizimi i projekteve dhe Implementimi i vlerave themelore të tilla si ndershmëria, respekti, falja dhe dhembshuria.

Rrënjët e punës shtrihen në Shqipëri, ku puna filloi menjëherë me shpërndarje ndihmash, pas rënies në vitin 1991 të perdes së hekurt Nga kjo u ngrit organizata humanitare ku njerëzit sot ndihmojnë me mënyra të ndryshme.

Më të dobtit e shoqërisë ndihmohen ndër të tjera me mensën, klinikën, vizitat e shërbimit në shtëpi dhe terapi të në qendër. U jep njerëzve mundësinë për të ndërtuar jetën e tyre dhe gjithashtu nxit iniciativat ekonomike dhe bamirëse. Një komponent i rëndësishëm i punës është arsimiti. Për këtë qëllim ka programe arsimore nga kopshti deri në Shkollën e Lartë dhe shumë oferta të tjera shkollimi, pa harruar të përmendim këtu programet e posaçme për fëmijët e varfër dhe romë.

Shkolla e Lartë ze një vend të rëndësishëm në punën ndërkombëtare. Studentë nga Evropa, Afrika dhe Amerika Latine nëpërmjet sistemit dual përfitojnë njohuritë e nevojshme për të filluar në vendet e tyre biznese apo projekte bamirëse ose për të udhëhequr organizata në mënyrë sa më profesionale. Diplomat njihen në Shqipëri, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qëllimi është që në të gjitha aktivitetet të ndihmohen njerëzit, pa dallim përkatësie etnike, ideologjie apo feje. Për një ndikim të qëndrueshëm është veçanërisht e rëndësishme, zbatimi i vlerave themelore.

Kontakt:

Vanessa Machoëtz (Zyra Berlin)
T +49 30 206089980
M +49 151 11313325
F +49 30 206089989
presse@nehemiah-Gateway.org

Nehemiah Gateway gGmbH
Kontumazgarten 3
90429 Nürnberg
www.nehemiah-Gateway.org

Viti i themelimit të Nehemiah Gateway gGmbH:
2010

Historia:

Organizata paraardhëse "Nehemia", e regjistruar në Shqipëri që nga viti 1992

Partner Menaxhues:

Arnold Geiger

Partnerë:

Erich Stamminger, Helmut Hauser

Forma ligjore:

(gGmbH). Kompania jofitimprurëse GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, burimet financiare të së cilës mund të përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse. Prandaj është e përjashtuar nga tatimet.

Zyra Qendrore:

Nuremberg; zyre përfaqësuese në Berlin dhe Boulder, CO / USA

Numri i të punësuarve:

139 (në Shqipëri, Gjermani, SHBA), si dhe shumë vullnetarë

Nehemiah Gateway Group:

Organizata nën ombrellën e Nehemiah Gateway

- Nehemiah Gateway gGmbH, Nuremberg (Headquarter)

- Fondacioni Nehemiah Gateway, Shqipëri

- Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway, Shqipëri

- Nehemiah Gateway Services gGmbH, Nuremberg (menaxhimi i aseteve)

- Nehemiah Gateway USA Inc.

- Shoqata për promovimin e institucioneve arsimore të Fondacionit NEHEMIA Shqipëri e.V.

Partneritete:

në Greqi, Tanzani, Ugandë, Sudan i Jugut, Etiopi, Meksikë, Shqipëri, Kubë (në planifikimin)

Financat:

Të ardhurat nga menaxhimi i aseteve tona dhe shërbimeve statutore të institucioneve me qëllime të ngjashme dhe aty ku është e mundur financiarisht, tarifat për shkollim, bëjnë të mundur financimin e gjitha shpenzimeve administrative si dhe shumë bursave dhe projekteve të ndihmës. Për më tepër, projektet e ndihmës janë mbështetur nga donacione që shkojnë 100% për projektet, pa ndonjë zbritje për shpenzimet administrative.

Organizata fitoi pavarësinë në organizim në sajë të kontributeve të Nehemiah Gateway Services gGmbH. Bilanci i Nehemiah Gateway mund të gjindet në Fletoren Zyrtare online www.bundesanzeiger.de me fjalët kyçe "Nehemiah Gateway".

Emri dhe Identiteti i korporatës:

Nehemia ka qënë një personalitet drejtues në Dhjatën e Vjetër, që rindërtoi murin mbrojtës të qytetit të Jeruzalemit. Shumë njerëz u kthyen në portat e qytetit „Gateways“. Nehemia u kujdes për çështjet sociale të popullit dhe u ktheu të përndjekurve identitetin e tyre. Në këtë raport, elementët kryesorë të Corporate Identity tonë janë si simbole "Nehemiah" dhe "Gateway".

Materiale të shkarkuara për shtyp



Logo e Nehemiah Gateway



Arnold Geiger
Foto: Jutta Benzenberg



Kampusi i Shkollës së Lartë në Shqipëri



Shkolla Amaro Tan
Foto: Jutta Benzenberg



Shkolla e Lartë "Nehemiah Gateway"
Programi Bachelor



Shkolla e Lartë "Nehemiah Gateway"
Programi Master



Kemondo – Laborator shkolle



Shqipëri – Projekti ,Siguria rrugore



Greqi – sallë shumëpërdorimshme

Shkarko për print:

(afro 55 MB, DIN A6, CMYK, 300 dpi, .tif dhe .eps)

www.nehemiah-gateway.org/downloads/presseNG_presse_CMYK.zip

Shkarko për internet:

(afro 13 MB, 1748 x 1240 px, RGB, 300 dpi, .jpg)

www.nehemiah-gateway.org/downloads/presse/NG_presse_RGB.zip